



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivuty	19.05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIPUSHICK	2943/2022		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.332/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-krjetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.332/2022 të datës 05.04.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ përmes përfaqësuesit të autorizuar _____ me adresë: _____ kundër organit të punësimi-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.332/2022 të datës 05.04.2022, e parashtruar nga ankuesi:

II. MBETET në fuqi Deklarimi i statusit të zyrtareve publik për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, i datës 09.06.2021, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si dhe Njoftimi i datës 15.06.2021, i Njësisë së Personelit i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me deklarimin e statusit të ankuesit sipas Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal fillimisht ka themeluar marrëdhënien e punës sipas Kontratës së punës me numër 079/1 të datës 07.08.2006 në pozitën “Korrier” në Divizionin e Logjistikës, në Departamentin e Administratës dhe Mbështetjes, ndërsa me datë 05.11.2013 i është lëshuar Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit në pozitën “Korrier” në Departamentin për Administratë dhe Financa, me të cilin akt emërim është riklasifikuar në pozitën e njëjtë „Korrier” me qëllim të organizimit të ri të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të përcaktuar me Rregulloren Nr. 03/2013 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 09.06.2021 ka përcjell në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, listën e verifikimit të deklarimit të statusit të zyrtareve publikë për këtë institucion, ndërsa me datë 15.06.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka njoftuar ankuesin lidhur me deklarimin e statusit sipas DMZP-së gjegjësisht se statusi i pozitës "Korrier,, është vendosur në kategorinë e nëpunësve administrativ teknik dhe mbështetës.

Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 21.06.2021 ka njoftuar zyrtaret e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se ankuesi dhe 3 zyrtarë tjerë gabimisht janë cilësuar si nëpunës administrativ dhe mbështetës, dhe ka kërkuar që tu përmirësohet akt emërimi dhe të ju njihet statusi i shërbyesit civile sipas detyrës zyrtare „Zyrtar për Arkivë“ nga katalogu i vendeve të punës .

Ankuesi me datë 04.11.2021 ka njoftuar menaxhmentin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, se nga data 04.11.2021 do të hyje në grevë për shkak mos rregullimit të statusit të tij dhe të shkeljes së drejtave që i takojnë si nëpunës civil.

Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.01.2022 nxjerr Vendim me numër protokoll 02-99, me të cilin formon Komisionin për shqyrtimin e statusit të katër (4) zyrtareve të MAPL-së të cilët nuk i kanë të harmonizuar Aktet e emërimit me katalogun e vendeve të punës. Komisioni për shqyrtimin e statusit të katër (4) zyrtareve të MAPL-së, me datë 15.02.2022 i dorëzon Sekretares së Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, raportin e shqyrtimit të lëndës me numër protokoll 02-99/1, duke i propozuar që ankuesit ti caktohet pozita sipas katalogut të vendeve të punës „Zyrtar për Arkiv 4“ në pajtim me nenin 83 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi i pakënaqur me mosveprimin e organit të punësimit me datën 05.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 1874/2022, kundër heshtjes administrative të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me implementimin e rekomandimit të Komisionit me numër protokoll 02-99/1 të datës 15.02.2022 për shqyrtimin e statusit të katër (4) zyrtareve të MAPL-së të cilët nuk i kanë të harmonizuar Aktet e emërimit me Katalogun e Vendeve të Punës, konkretisht me pretendime ankimore për njohjen e statusit të shërbimit civil sipas raportit të Komisionit me numër protokoll 02-99/1 të datës 15.02.2022, duke propozuar që ti lëshohet Akt emërimi për pozitën "Zyrtar për Arkiv 4".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.04.2022, kërkesën për përgjigje në ankesë e ka proceduar tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa me datë 20.04.2022 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës prej 1/43 faqe, si dhe provën shtesë (E-mailin) e datës 12.05.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me date 16.05.2022 ka kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë listën për verifikimin e statusit të zyrtarëve publike për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 17.05.2022 e ke dërguar në Këshill listën për verifikimin e statusit të zyrtarëve publike për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 05.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e punës nr.079/1 me datës 07.08.2006; Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit, i datës 05.11.2013; Titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës; E-mail i datës 15.06.2021; E-mail i datës 01.03.2022; E-mail i datës 104.11.2021; Vendimi për formimin e komisionit i datës 31.01.2022; Raporti me rekomandim i komisionit për shqyrtimin e statusit i datës 15.02.2022; Formulari i vlerësimit të punës i datës 21.01.2021; kartela e identifikimit për ankuesit i MAPL-së; Lista e pagave për ankuesit i datës 01.02.2022; Përgjigje në ankesë në forme elektronike e datës 17.05.2022 per prova shtesë nga MAPL-së; E-mail përgjigje e datës 12.05.2022 nga njësia e personelit të MAPL-së; Formulari i vlerësimit të punës i datës 07.01.2020; Përgjigje me E-mail i datë 20.04.2022 në kërkesë të KPMSHCK-së; E-mail i datës 19.04.2022; Akt emërim i datës 06.03.2012; Kërkesa për pushim e datës 20.11.2019; ; Kërkesa për pushim e datës 28.01.2020; E-mail i datës 15.06.2021; Formulari i vlerësimit të punës i vitit 2018; E-mail i datës 03.03.2021; Shkrese opinion ligjor i datës 23.02.2022 për MAP; Përgjigjja e Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes e-mail të datës 09.03.2022; Vendimi i datës 01.03.2021 nr. protokolli 111-16/2; Vendimi i datës 20.04.2021 me numër Anr.131/2021 nga KPMSHCK-së; Përgjigje e datës 19.04.2022 për KPMSHCK-së, bashkangjitur tabela e statusit të nëpunësve të MAPL-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara ka konstatuar se ankuesi fillimisht ka themeluar marrëdhënien e punës sipas Kontratës së punës me numër 079/1 të datës 07.08.2006 në pozitën "Korrier" në Divizionin e Logjistikës, në Departamentin e Administratës dhe Mbështetjes në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa me datë 05.11.2013 i është lëshuar Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit në pozitën "Korrier" në Departamentin për Administratë dhe Financa, me te cilin akt emërim është ri klasifikuar në pozitën e njëjtë „Korrier” me qëllim të organizimit të ri të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të përcaktuar me Rregulloren Nr. 03/2013 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës.

Ankuesi me date 05.04.2022 ka parashtruar në ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me implementimin e rekomandimit të Komisionit me numër protokolli 02-99/1 të datës 15.02.2022 për shqyrtimin e statusit të katër (4) zyrtareve te MAPL-së te cilët nuk i kanë të harmonizuar Aktet e emërimit me Katalogun e Vendeve të Punës, konkretisht me pretendime ankimore për njohjen e statusit të shërbimit civil sipas Raportit të Komisionit me numër protokolli 02-99/1 të datës 15.02.2022, duke propozuar që ti lëshohet Akt emërimi për pozitën "Zyrtar për Arkiv 4", mirëpo Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit ka gjetur se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me date 23.02.2022 ka kërkuar opinion ligjor nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me

implementimin e rekomandimit të Komisionit me numër protokolli 02-99/1 të datës 15.02.2022 për shqyrtimin e statusit të katër,(4) zyrtareve të MAPL-së, gjegjësisht lidhur me harmonizimin e zyrtareve të lartcekur, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 09.03.2022 përmes e-mali zyrtar i kthen përgjigjeje Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke e njoftuar se këto pozita sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafi 6 kategorizohen në nëpunës administrativ, teknik dhe mbështetës. Andaj Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në faktet e lartcekura konstaton se Komisioni me numër protokolli 02-99/1 i datës 15.02.2022 për shqyrtimin e statusit të katër,(4) zyrtareve të MAPL-së, nuk ka kompetencë të vendose lidhur me deklarin e statusit të zyrtareve publike por këtë mandat e ka Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ashtu siç përshihet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publike përkatësisht nenin 83 paragrafit 16 dhe 17 ku është përcaktuar se: *„Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklaramit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative”*.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se institucionet e administratës publike në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë qenë të obliguara që të bëjnë deklarin e statusit të zyrtarëve publikë, siç është përcaktuar me nenin 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht paragrafi 5 i këtij neni, ku përcaktohet se *„Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafit 6, ku përcaktohet se: *Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike, dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi në kohën e deklaramit të statusit ka qenë i emëruar në pozitën e punës “Korrier” vlerëson se organi i punësimit në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë , me rastin e përcaktimit të statusit ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sepse i njëjti është kategorizuar si *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës* ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Bazuar si me lartë Kolegji konstaton se deklarimi i statusit të ankuesit dhe kategorizimi i tij si *Nëpunës administrativo-teknik-dhe mbështetës* është në pajtim me nenin 2 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 83 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, andaj pretendimi ankimor i ankuesit për shkelje të dispozitave ligjore me rastin e përcaktimit të statusit është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.332/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

